

# NJOFTIM PËR SUBJEKTIN E RIVLERËSIMIT, Z. ADNAN KOSOVA

12/20/2018

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit njofton se, pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe zhvillimit të seancës dëgjimore më datë 19.12.2018 për subjektin e rivlerësimit, z. Adnan Kosova, bazuar në ligjin nr. 84/2016, sot, më datë 20.12.2018 vendosi:

Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, Adnan Kosova, prokuror në Prokurorinë e Përgjithshme.

Vendimi i arsyetuar me shkrim nga trupa gjyquese e kryesuar nga znj. Pamela Qirko, znj. Xhensila Pine relatores, znj. Genta Tafa (Bungo) anëtare, do t'u njoftohet subjektit të rivlerësimit, komisionerëve publikë dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve.

Ndaj këtij vendimi, mund të ushtrohet ankimi pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.